



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sherbim organizimi aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,578,950 (gjashte milion e pesëqind e shtatedhjetë e tete mijë e nentëqind e pesëdhjetë) Lek pa Tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta të kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kerkohet kjo vlere duke marre ne konsiderate rendesine dhe vleren e pretevitit te sherbimit qe kerkohet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”, ku parashikohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesi dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese sipas legjislacionit ne fuqi operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj si dhe rendesine e vecante që shfaq ky shërbim. Përvoja e mëparshme është element shumë i rendesishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 5 (pese) punonjës për periudhën Nentor 2025 – Janar 2026, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nentor 2025 – Janar 2026.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nentor 2025 – Janar 2026.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se rendesia e këtij shërbimi për AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administratë tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a- Të paktën 1 (një) Inxhinier Elektrik (Diplome Universitare + kontratë pune) për ndjekjen e ndricimit artistik të skenës dhe lidhjet e energjisë elektrike në perputhje me Kushtet teknike të sigurisë në punë.

b- Të paktën 1 (një) Inxhinier elektronik (diplome Universitare + kontratë pune) për montimin e pajisjeve elektronike, Pajisjeve audiofonike, sistem mikrofonë wireles për koncert live dhe organizimin e eventeve.

c- Të paktën 3 (tre) punonjës (kontratë pune) për montimin dhe çmontimin e skenave portative, led wall, ndricimin skenik, etj, si dhe realizimin e shërbimit.

Për plotësimin e këtij kriteri OE-te duhet të paraqesin: Diplomat universitare, Kontratat e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Nëntor 2025 – Janar 2026.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar

kontratën. Prania e stafit teknik për afatin e kërkuar në listëpagesa i vërteton AK se operatori ekonomik ka një staf të qëndrueshëm, operativ i cili do të kryejë shërbimin në kohë dhe çilesi.

Gjithashtu, në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, ky kriter është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

-Në lidhje me disponimin e Inxhinierit Elektrik theksojmë se është e nevojshme për ndjekjen e ndricimit artistik të skenës dhe lidhjet e energjisë elektrike në përputhje me Kushtet teknike të sigurisë në punë. Prania e Inxhinierit Elektrik në montimin dhe çmontimin e pajisjeve të ndricimit dhe lidhjeve të tjera elektrike duhet të bëhet nën mbikqyerjen e një inxhinieri të kualifikuar pasi mund të rrezikohet jeta e punonjësve apo qytetarëve të tjerë.

-Në lidhje me disponimin e inxhinierit elektronik theksojmë se është e nevojshme për montimin e pajisjeve elektronike, Pajisjeve audiofonike, sistem mikrofona wireless për koncert live dhe mbarevajtjen e aktiviteteve pasi aktivitet kryesorë kanë të përfshirë edhe koncerte festive për të cilat duhet të përdoren pajisje elektronike.

- Në lidhje me disponimin e punonjësve të thjeshtë theksojmë se janë të nevojshëm për montimin dhe çmontimin e skenave portative, led wall, ndricimit skenik, vendosje karrigesh etj, si dhe realizimin e shërbimit në përputhje me preventivin e shërbimit.

Theksojmë se ndër të tjera është kërkuar si më poshtë:

Skena duhet të jetë e qëndrueshme me sipërfaqe 60 m ² që të rrisë standartin e aktiviteteve të Bashkisë Lezhë, Strukturë e qëndrueshme për përdorim të jashtëm, Material: çelik dhe alumini i trajtuar, Dysheme e fortë dhe rezistente ndaj peshës së ekipit dhe artistëve, Sigurim i stabilitetit me mbështetje shtesë për terrene të ndryshme Përshtatje për performanca live, koncerte dhe aktivitete promovuese. Pësia e ngarkimit 750 Kg/m ² - sipas DIN 15921, Sipërfaqja e sipërme: dru i laminuar kafe me teksturë ekzagonale.
Pajisje audiofonike, sistem mikrofona wireless për koncert live & dj (25.000 watt – rms)- (me 3 sisteme) (bas-mid-stereo-monitorea) dhe urat mbajtëse për sistemin e pajisjeve audio-fonike dhe podin për pult komand, Pajisjet përfshijnë: amplifikatorë, monitorë skene dhe urat mbajtëse, Pod për pult komand të kontrollit audio, Instalimi për performancë të jashtme dhe të brendshme, Sigurim i cilësisë së zërit, pa ndërprerje dhe me mbulim të plotë të skenës, 6 mikrofona valor.
Ndriçimi artistik i skenës me sisteme light , 8 robote & komand automatik me mikser etj) Ndriçim LED dhe spot për efekt artistik, Kontroll automatik për ndryshim, ngjyrash dhe efektesh, Mikser i integruar për sinkronizim me muzikën dhe performancën, Instalim i përshtatshëm për skenë portative dhe outdoor.

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave të mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit si edhe përgjigjet testit të proporcionalitetit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, kryerjen e

shërbimit nga operatorë të kualifikuar e të cilët disponojnë staf të specializuar për realizimin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

-1 (një) mjet transporti me kapacitet mbajtes min 3.5 ton,

në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi për transportin e mallrave deri në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

- Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara, OE duhet të paraqesë:

a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, siguracion, taksa, pronësia).

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjetit të marre me qira ose kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit të mesipër duhet të paraqiten edhe Kontrate e qirase/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike, për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjetit në pronësi ose qira ose kontrate bashkepunimi është vlerësuar si e nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimit sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontratës. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkepunimi pajisjet e mëposhteme:

1. Skene portative
2. Pajisje audiofonike dhe sistem mikrofona wireles për koncert live
3. Ndricim skenik
4. LED Wall

- Për të provuar disponimin e pajisjeve të kërkuara, OE duhet të paraqesë:

a- Për pajisjet në pronësi duhet të paraqesë fturen tatimore të blerjes ose deklaratën doganore.

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e pajisjeve të marre me qira ose kontrate bashkepunimi, krahas dokumentacionit të mesipër duhet të paraqiten edhe Kontrate e qirase/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojces perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kane në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike, për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjetit ne pronesi ose qira ose kontrate bashkepunimi eshte vlerësuar si e nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimit sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Theksojme pjesa me e konsiderueshme e preventivit të shërbimit si dhe aktivitetet me te rendesishme kerkojne pajisje teknike si Skene portative, Pajisje audiofonike dhe sistem mikrofona wireles për koncert live, Ndricim skenik dhe LED Wall pa te cilet nuk mund te realizohen aktivitetet me te rendesishme per autoritetin kontraktor.

Duke gene se keto pajisje kane nje vlere te konsiderueshme, si dhe kane nje rendesi te vecante per organizimin e aktiviteve nevojitet disponimi i tyre ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi nga operatorët ekonomike ofertues.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin me mjetet dhe stafin e tij ne perputhje me preventivin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Referuar natyrës së veçantë, të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë dhe shëndetit dhe sigurisë në punë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar termat e references, në të cilën thekson se janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia përgjegjëse në termat e references argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Person Përgjegjës

Anetar

Anëtar